

## Syllabusi i lëndës

**Lënda:** Tefsir – Studime analitike rreth teksteve të tefsirave

**Programi i studimit:** Teologji Islame

**Numri i ECTS kredive:** 6

**Statusi i lëndës:** O

**Kodi i lëndës:** 302

**Fondi i orëve:** 2+2

**Viti akademik:** 2024/2025

**Semestri:** III

**Mësimdhënësi:** Prof. ass. dr. Lulzim Esati **Kontakti: e-maili:** lulzimesati@gmail.com

### Qëllimi i lëndës

Në lëndën e tefsirit-III- gjegjësisht: *studime analitike rreth tekstit të tefsirit*. I epet mundësia studentit të –FSI- që të njoftohet për së afërmi me tekstin origjinal të tefsirit. Nga pamundësia e përfshirjes të gjitha teksteve të tefsirit që arrijnë mbi 150. ne kemi zgjedhur tre Mufesirë më të njohur që komentojnë dhe interpretojnë tekstin e Kuranit famëlartë. Imam err- Rraziu i cili ka jetuar në shek. VI<sup>të</sup> h. dhe ka bekgroft filozofik në qasjen e interpretimit. El-Kurtubiu i cili ka jetuar në shek. VII<sup>të</sup>, dhe ka një bekgraunt të fikut- jurispodencës islame. Dhe Ibën Kethirit i cili ka jetuar në shek. VIII<sup>të</sup>, dhe ndjek metodën tradicionale në komentimin e tekstit të Kuranit f.

Duke e pajisur kështu studentin me njohuri të mirëfilltë rreth tekstit origjinal të komentatorëve të Kuranit Famëlartë, pa ndërhyrjen e askujt. Dhe të njoftohet me dallimet e këtyre kolosëve të tefsirit dhe në metodat e tyre gjatë qasjes së interpretimit të librit të Allahut s.v.t.. Si dhe ti jepet mundësi studentit që në formë kritike duke nxitë debate, të jene sa më objektiv gjatë shfrytëzimit të literaturës së tefsirëve klasike.

Zhvillimi i shkathtësive dhe aftësive për të analizuar çështjet të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me librin e Allahut në bazë të referimit të drejtë në librat e tefsirit, dhe komunikimin e saktë të mesazheve të tyre, dhe ruajtja nga keq interpretimin e teksteve të tyre të tefsirit.

### **Rezultatet e pritura të nxënies:**

#### **Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje të:**

Të përshkruaj etapat e zhvillimit të tefsirit gjatë historisë.

Të krahasoj ndërmjet teksteve të ndryshme të interpretuesve të cilat i studion gjatë kursit.

Të diskutoj rreth dallimeve të këtyre teksteve në bazë të argumenteve të secilit interpretues, duke qenë sa më objektiv në parashtrimin e tyre.

Të mbroj qëndrimet e secilit interpretues, ashtu siç i konceptojnë ithtarët e tyre.

Të prezantoj mendimin kritik ndaj secilit prej tyre, duke ia parashtruar argumentet e secilës shkollë të tefsirit.

Të jetë në gjendje që njohuritë e fituara t'i aplikoj gjatë trajtimit të temave dhe çështjeve të ndryshme ndërfetare.

### **Metodologjia e mësimdhënies:**

Mësimi do të zhvillohet sipas metodës së studimit komperativ dhe atij analizues.

### **Përmbajtja e lëndës:**

**Java e parë:** Hyrje, Njohja me syllabusin, metoda, organizimi, kërkesat dhe vlerësimi. Dhe njohja e tyre me studime analizuuese dhe krahasimore (komperative) rreth teksteve origjinale të tefsirit në etapat e ndryshme. Kontributi i dijetarëve islam të mëhershëm në tefsir dhe metodat e tyre në këtë shkencë të komentimit dhe interpretimit të Kuranit Famëlartë.

**Literatura:** err-Rraziu, Muhammed Ibën Omer, v 606h/1209, *Mefatihul Gajb*, botimi i tretë, (sh.b: Dar Ihja et-Turath el-Arabij, Bejrut). El-Kurtubiu, Muhamed Ibën Ahmed, v 671 h./1272, *el-Xhamiu Liahkamil Kuran*. sh.b. Muesesetu Rrisale, Bejrut, botimi i I-të 2006. Ibën Kethiri, Ebul fida, Ismail ibën Kethir, v 774 h, *Tefsirul Kur'anil Adhim*, botimi i parë, sh.b: Darul Misrije, Kairo, 1988.

**Java e dytë:** Mendimet e Mufeirëve-komentatorëve të Kuranit rreth shkronjave simbolike – të ndara në fillim të surëve nga tefsiri i Ibën kethirit.

**Literatura:** literatura e lartpërmendur, f: (30-34), Ibën kethiri. F: (154-155), tefsir el – Kurtubi.

**Java e tretë:** Përdorimi i popullit arab të shkronjave simbolike gjatë komunikimit, para zbritjes së Kuranit f. nga tefsiri i el-Kurtubiut. Kuptimi i fjalës *el-Kitab* në kontekstin Kuranor, si dhe përemri *dhelike* sipas Kurtubiut. Kuptimet dhe sinonimet e fjalës *Rejbë*.

**Literatura:** F: (155-161). tefsir el –Kurtubi.

**Java e katërt:** Transmetimet që përkufizojnë domethënien e nocionit *el-Muttekin*- të devotshmit në tefsirin e Ibën Kethirit, si dhe veçimi i udhëzimit për të devotshmit.

**Literatura:** f: (92-97). Tefsir Ibën Kethiri,

**Java e pestë:** Kuptimi i fjalës *el-Gajbë* – që besojnë në të fshehtën dhe d.m.th. e fjalës *et-Takva*- devotshmëria. Shtjellimi i nacionit *el-Huda*- udhëzim sipas Kurtubiut. Dhe llojet e udhëzimeve në tekstin e Kuranit F.

**Literatura:** f: (97-99). Tefsir Ibën Kethiri, f:(161-163). tefsir el –Kurtubi.

**Java e gjashtë:** Qëndrimi i Kurtubiut ndryshon nga qëndrimi i Ibën Kethirit, rrethmendimit të këtij të fundit se Kurani është udhëzues vetëm i atyre që i besojnë.

**Literatura:** f: (164-167) tefsir el –Kurtubi.

**Java e shtatë:** Përdorimi i nacionit *es-Salatu* në kontekstin e ajeteve të Kuranit sipas Kurtubiut.

**Literatura:** f: (169-175). tefsir el –Kurtubi.

#### **Java e tetë: Testi intermedier**

**Java e nëntë:** Imam err-Rraziu afron 21 mendime të dijetarëve që merren me interpretimin e Kuranit rreth shkronjave simbolike, në fund përkrah mendimin se ato janë emra të surëve-kaptinave të Kuranit. Sqarimi i emrit (*el-Kitab*) në Kuran dhe 31 emrave të tjerë të librit të Allahut s.v.t., sipas Imam err-Rraziut.

**Literatura:** f: (1-20).

**Java e dhjetë:** Rraziu preferon ndaljen në (*la Rejbe fihi*) gjatë leximit të këtij ajeti të Kuranit, si dhe sqaron d.m.th. e fjalës *Rejbë* , Mendimi i Rraziut; se kush mundë të quhet besimtarë gjatë komentimit të ajetit (*ata që besojnë në të fshehtën*), dhe sjell mendimet e të gjitha fraksioneve islame rreth kësaj çështjeje.

**Literatura:** f: (22- 31).

**Java e njëmbëdhjetë:** Debati mes *ahli sunnetit* Esh-arij & Maturidij dhe Mu,rezilëve se harami është rizkë, a jo? Nga tefsiri i Rraziut. Kuptimi i nocionit *Jekiin* sipas Rraziut dhe sqarimi i zbritjes së vahjit- shpalljës.

**Literatura:** f: (33- 37).

**Java e dymbëdhjetë:** Domethënia e fjalës *Kufër* – mosbesim në terminologjinë e Kuranit f. sipas Rraziut, dhe domethënia e fjalës *Kufër* – mosbesim në terminologjinë e Kuranit f. sipas Kurtubiut.

**Literatura:** f: (42-44). Kurtubi, f: (183-185).

**Java e trembëdhjetë:** Dallimi në mes këtyre shprehjeve që përsëriten shpesh në Kuran të cilat ngjajnë se kanë një kuptim; *el-akël*- mendja, *el-Kalbë*-zemra, *el-fuad*, *es-sadër*-gjoksi sipas Kurtubiut. Urtësia e radhitjes së besimtarëve dhe atributet e tyre së pari në suren (*el-Bekare*) pas tyre jo besimtarët dhe së fundi munafikët- hipokritët. Kurtubi.

**Literatura:** f: (189-196).

**Java e katërbëdhjetë:** Fillet e nifakut- hipokrizisë dh llojet e trazirave –fesadit të munafikëve sipas Ibën Kethirit. Shembulli i zjarrit dhe i shiut rrebesh – i shoqëruar me bubullima e vetëtima dhe rrëfe, që përshkruajnë gjendjen jo stabile të munafikëve-hipokritëve në Kuran f. Ibën Kethir.

**Literatura:** f: (112-136).

**Java e pesëmbëdhjetë: Provimi final**

**Literatura:** Kur’ani Kerimi, me përkthim nga efendi Hasan Nahi. Botimi 1986.

Err- Rrazi, Muhamed bin Omer, v 606 h./1209, *Mefatihul Gajb*, botimi i tretë, (sh,b: Dar Ihja et-Turath el-Arabij, Bejrut).

El-Kurtubi, Muhamed Ibën Ahmed, v 671 h./1272, *el-Xhamiu Liahkamil Kuran*. sh.b. Muesesetu Rrisale, Bejrut, botimi i I-të 2006.

Ibën Kethir, Ebul fida, Ismail ibën Kethir, v 774 h, *Tefsirul Kur'anil Adhim*, botimi i parë, sh.b: Darul Misrije, Kairo, 1988.

*Kandili ndriçues*, versioni e shkurter i tefsirit të Ibën Kethirit- përktheu Mr. Bashkim Aliu, i botuar nga fondacioni i rinisë islame në Cyrih, 2007.

Ibën Mendhur, Xhemaludin Muhamed Ibën Mukrem, v 711.h./1311, *Lisanul Arab*, sh.b. Dar Sadir, Bejrut, botimi i I-të 1990.

El-Fejruz Abadi, Muhamed Ibën Jakub, v 817 h./1414, *Elkamus Elmuhit*, sh.b. Muesesetu Rrisale, Bejrut, botimi II-të 1987.

**Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:**

**Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%**

**Punimi seminarik 20%**

**Testi intermedier 30%**

**Provimi final 40%**

**Total 100%**

### **Literatura obliguese:**

1. Err- Rrazi, Muhamed bin Omer, v 606 h./1209, *Mefatihul Gajb*, botimi i tretë, (sh.b: Dar Ihja et-Turath el-Arabij, Bejrut).
2. El-Kurtubi, Muhamed Ibën Ahmed, v 671 h./1272, *el-Xhamiu Liahkamil Kuran*. sh.b. Muesesetu Risale, Bejrut, botimi i I<sup>-të</sup> 2006.
3. Ibën Kethir, Ebul fida, Ismail ibën Kethir, v 774 h, *Tefsirul Kur'anil Adhim*, botimi i parë, sh.b: Darul Misrije, Kairo, 1988.

### **Literatura shtesë dhe bibliografia:**

1. **Sejjid Kutb, fi dhilalil Kuran, botimi i 25-të, sh.b. Darush shuruk, Bejrut, 1996.**
2. *Kandili ndriçues*, versioni e shkurter i tefsirit të Ibën Kethirit- përktheu Mr. Bashkim Aliu, i botuar nga fondacioni i rinisë islame në Cyrih, 2007.
3. **Ibën Ashur, Muhamed Tahir. Et-Tahrir ve-t- Tenvir, Tunis: Dar tunisije, 1984.**
4. **Muhamed el-Gazali, Komenti tematik i Kuranit famëlartë, sh.b. Logos, 2007, Shkup.**

### **Kontributi në ngarkesën e studentit**

<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë\Javë</b>	<b>Gjithsej</b>
<b>Ligjërata</b>	<b>2</b>	<b>15</b>	<b>30</b>
<b>Ushtrime teorike</b>	<b>2</b>	<b>15</b>	<b>30</b>

<b>Punë praktike</b>	<b>1</b>	<b>10</b>	<b>10</b>
<b>Kontaktme me mësimdhënësin\konsultimet</b>	<b>1</b>	<b>15</b>	<b>15</b>
<b>Ushtrime në terren</b>			
<b>Kollokfiume, seminare, ese</b>	<b>1</b>	<b>10</b>	<b>10</b>
<b>Detyra të shtëpisë</b>	<b>1</b>	<b>10</b>	<b>10</b>
<b>Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)</b>	<b>1</b>	<b>15</b>	<b>15</b>
<b>Përgatitja përfundimtare për provim.</b>	<b>5</b>	<b>3 ditë</b>	<b>15</b>
<b>Koha e kaluar në vlerësim (teste, ese, provim final)</b>	<b>3</b>	<b>5 ditë</b>	<b>15</b>
<b>Totali</b>	<b>17</b>	<b>15 javë</b>	<b>150</b>